




European Bank
for Reconstruction and Development

HISTORI SUKSESI
NËNTOR 2020

KOSOVO SME
Competitiveness Support Programme



ZGJERIMI I BIZNESIT DUKE U KUJDESUR PËR MJEDISIN

Flexograf SH.P.K. është një kompani e specializuar në industrinë e printimit dhe flexo-printimit. E themeluar në vitin 2012, kompania është bërë një konkurrente e njohur në tregun e shërbimeve të shtypjes. Kompania ofron një larmi të gjerë printimit në paketim, etiketave vetë-ngjitëse, etiketa të mbështjellura dhe produkte të ngjashme të printuara për industritë ushqimore dhe jo-ushqimore. Ka pesë departamente (dizenjimi, përgatitja e klisheve, shtypja, petëzimi dhe prerja) dhe operon aktivitetet e saj në një lokacion të ri prodhimi me 5,000 m². Kompania investon në teknologjitë më të fundit, në marketing por edhe në zhvillimin profesional të 45 punonjësve të saj. Stafit është kreativ dhe profesional, i gatshëm për t'i udhëzuar klientët në zhvillimin e paketimit që pasqyron nevojat dhe specifikimet e produktit, të dizajnuara për të nxjerrë në pah pozicionimin e favorshëm të çdo lloji produkti dhe duke u prodhuar me standardet më të larta të cilësisë.

Gjatë dy viteve të fundit, kërkesa për produktet e Flexograf u rrit ndjeshëm në tregun vendor si dhe në tregjet ndërkombëtare. Prandaj kompania vendosi ta zgjerojë kapacitetin e saj duke investuar në makineri të reja. Flexograf zgjodhi një makinë të re për printim digjital (Digital Imaging machine) për të përmbushur kërkesat e reja për kapacitetin e shtypjes.

Përveç se makineria e re zëvendësoi një makinë 20-vjeçare, investimi rezultoi në shumë përfitime. Krahas rritjes së dëshiruar të produktivitetit, teknologjia më e re funksionon pa tretës, duke ulur ndjeshëm përdorimin e materialeve të rrezikshme nga kompania dhe emetimin e aromave të dëmshme, duke përmirësuar përfundimisht Shëndetin dhe Sigurinë në Punë të punëtorëve. Për më tepër, makina e re ka standardizuar dhe thjeshtuar lloje të ndryshme të proceseve të shtypjes dhe harxhon më pak energji sesa makina që e zëvendëson.

Kompania fitoi ndihmë teknike falas për të optimizuar projektin e saj të investimit dhe gjithashtu fitoi grant në vlerë prej 15% pas verifikimit të suksesshëm të projektit, financuar nga Bashkimi Evropian.

Me këtë investim kompania tani plotëson një larmi standardesh evropiane, duke përfshirë:

- Rregullorja (KE) Nr. 1935/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 Tetorit 2004 mbi materialet dhe artikujt që synojnë të vijnë në kontakt me ushqimin
- Direktiva 2006/42 / EC për makineritë
- Direktiva 2014/35 / BE mbi Harmonizimin e Ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me Pajisjet Elektrike të Projektuara për Përdorim brenda Kufijve të Tensionit të Caktuar
- Direktiva 2014/30 / BE për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me pajtueshmërinë elektromagnetike

Vlera e kredisë	€ 140,000
Vlera e grantit	€ 21,000
Direktivat e BE-së të plotësuar	Rregullorja për materialet që janë të synuara të vijnë në kontakt me ushqimin, direktivat për makineritë dhe pajtueshmërinë elektromagnetike
Investuar në	Makinë e re për shtypje digjitale
Kursimet e energjisë	43.90 MWh/vit
Reduktimi i CO2	15.20 t CO2/vit

Konsulentët implementues



Për më shumë informata vizitoni uebfaqen e Programit: www.web-sme-csp.com ose na kontaktoni në:
+383 49 562 660 info.kosovo@web-sme-csp.com